



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241264
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05064787

C-IV.-14-4921

Ankuesi:

J D G nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Urata”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN103-0505 i dt.05 qershor 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.23 qershor 2014, përfaqësuesi i ankuesit ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN103-0505 i dt.05 qershor 2014, me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara nga NSH “Urata” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se ka të drejtë në paga të pa paguara dhe se e godet vendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të refuzimit të kërkesës për paga të pa paguara për periudhën kohore 16.10.2006 deri më 31.08.2007 në shumë prej 1,500.00€. Ka shtuar se ka punuar për NSH-në nga viti 1978 deri në kohën e hapjes së procedurës së likuidimit me dt.08.08.2007 dhe se kërkesën e ka parashtruar me kohë dhe se nuk është i vërtetë fakti se nuk ka qenë në marrëdhënie pune gjatë kohës për të

cilën e kërkon pagesën e të ardhurve personale. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e librezës së punës, Kontrata nr.745/2001 dt.31.10.2001, Aktvendim mbi caktimin e punëtorit në punës nr.776/2000 dt.19.10.2000, Padi drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë dt.08.02.2007, Formular i kërkesës për likuidim, Njoftimi për likuidim të NSH “Urata”, Parashtrësë drejtuar Zyrës Regjionale të AKP në Prishtinë dhe Kopja e vendimit të atakuar,

Me dt.30 shtator 2015, i autorizuari i ankuesit ka paraqitur parashtrësë për plotësimin e padisë me anë të së cilës kërkon pagesën e të ardhurave në emër të pagave të pa paguara në shumë prej 1,743.00€ me kamat ligjore.

Me dt.01 janar 2023 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit dhe konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL në marrjen e vendimit, por vetëm ka deklaruar se vendimi AL nuk është i bazuar. AL vëren se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet si të pa pranueshme ose të pa bazuar. Mbrojtjes ia ka bashkangjitur kopjen e vendimit të cilin ka kundërshtuar ankuesi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.23 qershor 2023, ka lëshuar një urdhër për ankuesin me të cilin ka kërkuar që të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç është lista e pagave – prova që NSH i ka mbetur borxh. Urdhëri është tentuar që ti dorëzohet tri herë, por zyrtari i postës kishte konstatuar “adresë jo e plotë” dhe “palën e kam thirr në telefon nuk është lajmëruar”. Përfundimisht urdhëri i është dorëzuar ankuesit përmes fletë dorëzimit personal me dt.28 gusht 2023.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuase), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse

palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por është kontestues fakti nëse NSH i ka mbetur borxh paga të pa paguara për periudhë e kontestuar 16.10.2006 deri më 31.08.2007, andaj nga shkresat e lëndës gjykata vije në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se NSH i ka mbetur borxh paga të pa paguara për këtë periudhë pasi që me asnjë provë nuk u vërtetuar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhërit të dt.23 qershor 2023, duke zgjedhur që të mos i përgjigjet të njëjtit.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se i takojnë pagat e pa paguara për periudhën kontestuese. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata morri parasysh provat të cilat i ka dorëzuar ankuesi së bashku me ankesë, por të njëjtat nuk i morri për bazë, pasi që me to nuk mund të dëshmohet se NSH i ka mbetur borxh ankuesit paga të pa paguara. Andaj, si e tillë nuk vërtetohet se ankuesit i takon e drejta e pretenduar me ankesë.

Sa i përket parashkrimit të kërkesës të cilën e paditura është thirrur, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimit është institut i veçantë me afate të përcaktuara me ligj. Por, në këtë rast gjykata u mbështet në provat e prezantuara nga ankuesi, të cilat ishin të mjaftueshme për t'ia refuzuar kërkesën përtej afateve ligjore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën me dt.25 nëntor 2022.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala